



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria -Vlada-Government*



**Këshilli i Sigurisë i Kosovës**  
**Savet Bezbednosti Kosova / Kosovo Security Council**

**Sekretariati / Sekretariat / Secretariat**

Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës- Qendra e Situatave shpall të lirë këtë vend të punës:

**I. Një (1) Zyrtar i Lartë për Grumbullim dhe Përpunim të Informatave**

**Numri i referencës: SKSK-QS-003**

**Koeficienti: 8**

**Vendi: Prishtinë**

**Detyrat dhe përgjegjësitë:** Nën mbikëqyrjen dhe përgjegjësinë e Drejtorit të Qendrës së Situatave, kryen detyrat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

- Bënë grumbullimin e informacioneve nga qendrat kryesore operative te institucioneve te sigurisë në Kosovë;
- Përgatitja e informacioneve për raporte ditore, dokumente statistikore, hulumtime, etj.;
- Merr pjesë në përpilimin e raporteve javore dhe mujore në bazë të raporteve të grumbulluara;
- Monitorim i përditshëm i medimeve elektronike dhe të shkruara në Kosovë duke përcjellë gjithë materialet ditore që kanë të bëjnë me sigurinë në Kosovë;
- Duhet të jetë i gatshëm të pranojë përgjegjësi dhe punë jashtë orarit të rregullt të punës;
- Duhet të jetë i gatshëm të punojë në bazë të rotacionit (të mbaj kujdestari) që caktohet nga Drejtori i Qendrës së Situatave;
- Personit mund t'i shtohen edhe përgjegjësi tjera në bazë të detyrave shtesë që merr me kalimin e kohës nga Drejtori i Qendrës së Situatave;

**Kualifikimet, aftësitë, përvoja dhe atributet tjera që kërkohen:** – Kandidati duhet të ketë diplomë universitare; Të ketë së paku 3 (tre) vite përvojë të punës; Njohja e gjuhës shqipe në të folur dhe shkruar, njohja e gjuhës angleze e dëshirueshme; Kandidati duhet të njohë punën me Kompjuter (Microsoft Word, Excel, Power Point, Acces) etj; Preferohen cilësi tjera të kandidatit: përvojë në pjesëmarrje në projekte, seminare, trajnime dhe Certifikata që dëshmojnë këtë përgatitje (është përparësi por jo esenciale).

**Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:** Përzgjedhja do të bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil, dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

**Paraqitja e kërkesave:** Formulari për aplikim mund të merret në recepcion në ndërtesën e Qeverisë së Republikës së Kosovës (rruga Nëna Terezë p.n.). Formularin zyrtar për aplikim mund ta gjeni edhe në web faqen: [www.kryeministri-ks.net](http://www.kryeministri-ks.net). Formulari zyrtar i konkurrimit duhet të dorëzohet së bashku me dëshminë për kualifikim shkollor, kurset e ndjekura, përvojën e punës, Certifikatën (dëshminë) që s'është nën hetime dhe dy referenca. Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe ai i pakompletuar me të dhënat e kërkuara do të konsiderohet i pavlefshëm.

Kërkesat mund të dorëzohen në zyrën e Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës, kati –II (minus dy), Ndërtesa e Qeverisë, ose me postë. Për informata shtesë, mund të telefononi në: 038 200 15 607.

*“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet e Kosovës”.*

*“Komuniteti jo - shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”.*

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrin brenda 4 ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Kandidatët të cilën hynë në përzgjedhje të ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga personeli.

**Kandidati/ja i/e përzgjedhur do ti nënshtrohet procedurave për verifikimin e sigurisë, të parapara në nenin 19 të Ligjit Nr. 03/L-050 mbi themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës.**

**Afati i konkursit është i hapur 15 ditë nga data e publikimit në shtypin ditor (prej datës 21 qershor 2014 deri më datën 05 korrik 2014 në ora 16:00).**